



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2024:091983

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505673

P.nr.64/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Dvizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.K nga Fushë Kosova, rruga "...", për veprë penale Ngacmimi, të parashikuar nga neni 182 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti të Përgjithshëm PP.II.nr.1392/2024, datë.21.03.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për dhënjën e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, PP.II.nr.1392/2024, datë.21.03.2024, me datë.**26.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET KËRKESA E PROKURORISË THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM në Prishtinë PP.II.nr.1392/2024, datë.21.03.2024, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: V.K, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur më datë ... në Drenas, tani e ka vendbanimin në Fushë Kosova, rruga "...", me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 30.01.2024, përmes numrit të tij të telefonit ishte përfshirë në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme dhe kishte komunikuar me qëllim të ngacmimit, frikësimit, me të dëmtuarin T.N-babain e ish gruas se tij S.K, pasi që të njëjtit kishin qenë të martuar dhe të cilët ishin ndarë, me të cilën ka edhe fëmijë, e që nga ndërprerja e marrëdhënies së tyre, i akuzuari kishte filluar të e shqetësonte, duke e thirrë në telefon në mënyrë të vazhdueshme dhe duke i përcjellë mesazhe, video dhe fotografi, me ç 'rast i dëmtuari, si pasojë nga këto veprime, ishte ndier i frikësuar edhe i shqetësuar emocionalisht ,-

-me këtë ka kryer veprë penale Ngacmimi, të parashikuar nga neni 182 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,38,43,69 dhe nenit 182 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 495,359,360,364,449 par.3. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e:

G J Y K O N

Të akuzuarin V.K ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej **260 (dyqind e gjashtëdhjetë) €**, të cilin detyrohet të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari V.K në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) ditë.

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg. Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimin ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimin me burg, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari T.N nga Drenasi nga Drenasi, rruga "...” nr..., Komuna e Drenasit, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Deparatamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1392/2024, datë.21.03.2024, ka akuzuar të akuzuarin V.K për veprë penale Ngacmimi, të parashikuar nga neni 182 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), poashtu ka ushtruar kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë pa mbajtjen e shqyrtimit

gjyqësor PP.II.nr.1392/2024, datë.21.03.2024, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepër penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, në vështirim të nenit 495 par.1. të KPP-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimin penal me nr.të rastit 2024-AC-0300, i datës 28.02.2024, të SP Veriu në Prishtinë, raportin fillestar të incidentit me nr.të rastit 2024-AC-0300, i datës 28.02.2024, të SP Veriu në Prishtinë, procesverbalin e marrjes në pyetje për të dëmtuarin T.N, i përpiluar me dt.31.01.2024, në SP Veriu në Prishtinë, mesazhet telefonike, procesverbalin e marrjes në pyetje për dëshmitaren S.K, i përpiluar me dt.06.02.2024, në SP Veriu në Prishtinë dhe procesverbalin e marrjes në pyetje për të dyshuarin-të akuzuarin V.K, i përpiluar me dt.27.02.2024, në SP Veriu në Prishtinë, konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer vepër penale Ngacmimi, të parashikuar nga neni 182 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vite, ashtu që gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e dënoi me gjobë në shumë prej 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) €, (nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) ditë, kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së), me bindjen se ky dënim me gjobë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen financiare të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet euro (20 €).

Vendimin që i dëmtuari T.N nga Drenasi nga Drenasi, rruga “...” nr..., Komuna e Drenasit., për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të udhëzohet në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 462 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.64/2024, datë:26.03.2024

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

Gj y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 496 par.2. të KPP-së. i akuzuari mund të ushtrojë kundërshtim në afat prej 8 ditë, nga dita e pranimi dhe kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate. Nëse kundërshtimi nuk hudhet për shkaqe të arsyeshme, atëherë gjykata do të caktoj mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë sipas aktakuzës së ushtruar. Nëse nuk paraqitet kundërshtimi apo paraqitet pas afatit, urdhëri ndëshkimorë merrë formën e prerë dhe ekzekutohet.